



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 523/2 prot.

Tiranë, më 09. 06. 2023

## V E N D I M

**Nr. 80, datë 09. 06. 2023**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>1</sup>, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 75, datë 15.05.2023, e S. S., ku pretendohet diskriminim, *për shkak të gjinisë, orientimit seksual, gjendjes shoqërore dhe gjendjes martesore*, nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore dhe P. S., me detyrë prokurore e Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, si dhe shtetasve K. P. dhe G. P.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri<sup>2</sup>,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Pretendimet sipas subjektit ankues.**

Ankuesja parashtron se jeton në të njëjtin pallat me shtetasit K. P. dhe G. P. Për shkak të shërbimeve që lidhen me pastrimin e ambienteve të përbashkëta, mes tyre ka patur konflikte të vazhdueshme. Lidhur me këtë, S. S., thekson se K. P. me profesion mësuese, pranë shkollës “Qamil Guranjaku”, në bashkëpunim me bashkëshortin, G. P., kanë paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ndaj ankueses për veprën penale të “Përndjekjes”.

Gjithashtu, pretendohet se K. P. dhe bashkëshorti i saj kanë paraqitur kallëzime të rreme pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, duke pretenduar se janë kërcënuar dhe ngacmuar nga ankuesja, në mënyrë të përsëritur duke u shkaktuar atyre gjendje ankthi dhe frike. Ankuesja thekson se nga ana e tyre, është fyer vazhdimisht në lidhje me faktin se ajo jeton me prindërit dhe është beqare, madje është aluduar se i ka ngacmuar seksualisht vajzat e saj.

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Lidhur me sa më lart, ankuesja pretendon se është vënë në pozita diskriminuese nga ana e zonjës dhe zotit P., për shkak të orientimit seksual, pasi aludohet se i ka ngacmuar seksualisht fëmijët, si dhe për shkak të gjendjes shoqërore dhe martesore, pasi ata duke e fyer i kanë vënë vazhdimisht në dukje faktin që jeton me prindërit dhe është beqare, e pamartuar.

Gjithashtu, për të njëjtat shkaqe, ankuesja pretendon se është diskriminuar nga oficerët e policisë gjyqësore dhe prokurores, P. S., të Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, pasi kanë administruar dhe pranuar kallëzimet e rreme të bashkëshortëve P. kundrejt saj. Sipas ankuses, nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore janë marrë kallëzimet e bashkëshortëve P. dhe i janë përcjellë prokurores, pa marrë më parë deklaratimet e ankuses. Gjithashtu, sipas saj, edhe nga ana e prokurores, P. S., vijnë procedurat hetimore, sa i përket kallëzimeve të sipërcituara edhe pse janë qesharake dhe të turpshme. Për këtë, ankuesja sqaron se i është drejtuar me ankesë Agjencisë së Mbikqyrjes Policore, për shpërdorim detyre nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurores, për shkak se kanë konsumuar veprën penale të shpërdorimit të detyrës.

Në këto kushte, ankuesja kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit ndaj shtetasve K. P. dhe G. P., si dhe oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurores, P. S., të Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për shkak të gjinisë, orientimit seksual, gjendjes shoqërore dhe gjendjes martesore.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:**

Ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqet e “*gjinisë, orientimit seksual, gjendjes shoqërore dhe martesore*” duke përcaktuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Neni 3, i ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Bazuar në nenin 33/3, të LMD-së përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me subjektet ndaj të cilëve ishte drejtuar ankesa, si dhe lidhjen e shkaqeve me situatën diskriminuese të pretenduar, dhe për këtë, më datë 16.05.2023, u mor kontakt me e-mail me S. S., duke i kërkuar plotësimin e saj.

Në përgjigje, subjekti ankues me e-mail-in datë 17.05.2023 informoi Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi duke vënë në diapozicion disa prapësime shtesë.

*i. Lidhur me pretendimet e ankueses ndaj K. P. dhe G. P.*

Plotësimi i kriterëve formale të një anese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë të parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44/2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, gërma b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: “Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:...b) legjitimitetin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjerash personash, përbën diskriminim”.

Për të vlerësuar legjitimitetin e palës kundër të cilit drejtohet ankesa, Komisioneri do i referohet parashikimeve të bëra në nenet 24, 25 dhe 26 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Kështu, në këtë kod përcaktohet përmbajtja e personit juridik: “24. Personat juridikë janë publikë dhe privatë. 25. **Personat juridikë publikë** janë institucionet e ndërmarrjet shtetërore, që financohen vetë ose nga buxheti i shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik.

*Institucionet dhe entet shtetërore, që nuk ndjekin qëllime ekonomike, nuk regjistrohen. 26. Persona juridikë privatë janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji”.*

Referuar parashikimeve të mësipërme, vlerësohet se “sektori publik” mund të përcaktohet si sektori që grupon të gjitha aktivitetet ekonomike dhe sociale që janë në ngarkim të administratës, ndërmarrjeve publike dhe organizmave publikë të sigurimeve shoqërore, ndërsa “sektori privat” mund të përcaktohet si sektori që grupon të gjitha aktivitetet ekonomike dhe sociale që janë në ngarkim të personave juridikë privatë, sipas përcaktimeve të nenit 26, të Kodit Civil.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në përmbushje të qëllimit të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, shqyrton ankesat që drejtohen kundër autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë.

Bazuar në informacionin e administruar, rezulton se, shtetasit K. P. dhe G. P., janë dy persona privatë, që banojnë në një pallat me ankuesen, që nuk ushtrojnë funksione publike dhe nuk ofrojnë shërbime publike/private kundrejt saj, pra janë persona që nuk marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë. Në këtë kuptim, konflikti mes ankueses dhe shtetasve K. P. dhe G. P., lidhet me mosmarrëveshje në kuadër të bashkëjetesës në komunitet, në pallat dhe jo me faktin nëse ata ofrojnë shërbime publike/private kundrejt saj.

Për sa më sipër, bazuar në dispozitat e cituara më lart dhe parashikimeve të bëra në ligjin 10221/2021 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, rezulton se, K. P. dhe G. P., nuk legjitimohen si subjekte kundër të cilëve mund të paraqitet ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>.

Bazuar në nenin 33/4, germa “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ... b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”.

ii. *Lidhur me pretendimet e ankueses ndaj oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurores, P. S., të Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.*

Pretendimet e ankueses ndaj oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurores, P. S., të Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, lidhen me administrimin, pranimin dhe vijimin e procedurave hetimore nga ana e tyre për kallëzimet e rreme të bashkëshortëve P. kundrejt saj. Sipas ankueses, vijimi i procedurave hetimore për kallëzimet e paraqitura nga këta shtetas, janë qesharake dhe të turpshme. Për këtë, ankuesja ka pretenduar se oficerët e policisë gjyqësore dhe

<sup>3</sup> Për analogji citojmë: Vendimi nr. 73, datë 19.03.2018, Vendimi nr. 120, datë 30.06.2021.

prokurorja, kanë konsumuar veprën penale të shpërdorimit të detyrës. Me anë të këtyre veprimeve, ankuesja pretendon se ata e kanë vënë në pozita diskriminuese për shkak të gjinisë, orientimit seksual, gjendjes shoqërore dhe gjendjes martesore.

Ligji Nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 283, parashikon se:

*“1. Çdo person që ka marrë dajeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.*

*2. Kallëzimi i paraqitet prokurorit ose një oficeri të policisë gjyqësore me gojë ose me shkrim, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit.*

*3. Kallëzimet anonime nuk mund të përdoren, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 194. Të dhënat e përmbajtjes së kallëzimit anonim mund të verifikohen nga prokurori ose policia gjyqësore për të siguruar elementë të provës, që konfirmojnë vërtetësinë e tyre”.*

Ndërsa në nenin 284, të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se:

*“1. Për veprat penale të parashikuara nga nenet 84, 89, 102 paragrafi i parë, 105, 106, 130, 148, 149, 243, 254, 264, 275, 290 paragrafi i parë dhe 318 të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e viktimës, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit.*

*2. Ankimi bëhet nga viktimja te prokurori ose në policinë gjyqësore me anën e një deklaratë, në të cilën personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të posaçëm, shfaqet vullneti që të procedohet në lidhje me një fakt të parashikuar nga ligji si vepër penale.*

*3. Kur ankimi bëhet me gojë procesverbali që mbahet për këtë qëllim nënshkruhet nga ankuesi ose përfaqësuesi i tij.*

*4. Ai që merr ankimin sigurohet për identitetin e ankuesit dhe i dërgon aktet prokurorit.*

*5. Për rastet e parashikuara nga neni 59, ankimi bëhet në gjykatë nga viktimja akuzuese.”*

Referuar legjislacionit të sipërcituar dhe përkatësisht neneve 283 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale, oficerët e policisë gjyqësore dhe prokurorja, P. S., në bazë të këtij detyrimi i kanë marrë kallëzim shtetasve, K. P. dhe G. P.

Ligji Nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 194, përcakton se: *“1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë; ...”.*

Përsa më sipër, legjislacioni parashikon se Inspektori i Lartë i Drejtësisë është autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve. Në rastin konkret,

sa i përket veprimeve të cituara në ankesë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjykon se nuk ka kompetencë për verifikimin e ankesave apo hetimin e shkeljeve disiplinore të kryera nga ana e prokurorëve, pasi ky autoritet i atribuohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “ Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”*. (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Sipas ligjit, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma, ndër të cilat, në formën e “*Diskriminimit i drejtpërdrejtë*”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2) ose në formën e “*Diskriminimit të tërthortë*” e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë



nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7). Ndërkohë, sipas nenit 6, të ligjit, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit*, *kufizimit*, *përrjashtimit* ose *preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohe vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Duke mbajtur në konsideratë standartet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, ankuesja nuk ka ngritur pretendime për diferencë në trajtim ose për dështimin e subjekteve kundër të cilëve ka paraqitur ankesën për të trajtuar ndryshe rastin e saj, për shkak të situatës në të cilën ajo gjendet, situatë e cila supozohet se ka si bazë gjininë, orientimin seksual, gjendjen shoqërore dhe gjendjen martesore.

Për shkaqet e pretenduara, ankuesja nuk ka dhënë asnjë sqarim dhe nuk ka depozituar asnjë provë për të vërtetuar ekzistencën e tyre, por është mjaftuar me pretendimin që denoncimet apo kallëzimet e marra nga ana e subjekteve ndaj të cilëve është drejtuar ankesa janë të rreme dhe nuk duhet të ishin administruar. Në këtë kuptim, Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person citon në ankesë se diskriminohet për shkak të gjinisë, orientimit seksual, gjendjes shoqërore dhe gjendjes martesore, nuk mjafton për të ngjitur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar, duhet të parashtrijë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur, që në çështjen objekt shqyrtimi janë gjinia, orientimi seksual, gjendja shoqërore dhe gjendja martesore.

Nga ana e ankueses, nuk është parashtruar apo argumentuar se veprimet apo mosveprimet e subjekteve ndaj të cilëve është drejtuar ankesa lidhen drejtpërdrejtë me shkaqet e pretenduara në ankesë.

Komisioneri vlerëson se, në thelb ankuesja ka ngritur pretendime për paligjshmëri të veprimeve në ngarkim të saj nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurores, P. S. Ankuesja pretendon se, për shkak se ata kanë konsumuar veprën penale të shpërdorimit të detyrës, duke marrë kallëzime të rreme e kanë vënë atë në pozita diskriminuese. Komisioneri nuk i hyn vlerësimit të veprimeve ose mosveprimeve të këtyre dy subjekteve, por bazuar në shpjegimet e ankueses nuk rezulton të ketë ndonjë *dallim, përjashtim, kufizim*, që bazohet në shkaqet e pretenduara në ankesë.

Pretendimet e ankueses nuk paraqesin elementë të trajtimit diferencues. Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33/4, gërma “b”, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 33, pika 4, shkronja b), nenin 33, pika 10 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 75, datë 15.05.2023, të paraqitur nga S. S., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja djeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Gjinia, orientimi seksual, gjendjen shoqërore dhe gjendjen martesore)



(Fusha: Të mira dhe shërbime)